



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E FINANCËS DHE PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT

Nr. 5646 Prot

Himarë, më 21.07.2025

Lënda: Dërgohet për miratim projektvendimi për “miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve buxhetore të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028”

KËSHILIT TË BASHKISË HIMARË
SEKRETARISË SË KËSHILLIT BASHKIAK

KËTU

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për Financat Vetëqeverisjes Vendore”, dhe Udhëzimit nr 19 datë 10.07.2025, të Ministrit së, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028”

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

- 1- Projektvendimin për “miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve buxhetore të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028”
- 2- Tabelat bashkëlidhur projektvendimit.
- 3- Relacion Shpjegues.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Konceptoi: M. Prifti
Miratoi: L. Mezani





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E FINANCËS DHE PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT

Nr. 5646 Prot

Himarë, më 21.07.2025

PROJEKTVENDIM
NR. 38 DATË 21.07.2025

PËR “MIRATIMIN E TAVANEVE PËRFUNDIMTARE TË SHPENZIMEVE BUXHETORE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028”

Mbështetur në nenet 34,40,41,45,55 të ligjit nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjin 9936 datë 26.08.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kreu III nenet 10-20, kreu IV nenet 20-29, kreu VII nenet 39-40 të ligjit Nr 68/2017 “Për Financat e Qeverisjes Vendore” ligjin Nr 10296 datë 08.07.2010. “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” të Ministrisë së Financave “Mbi përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028”, bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 , datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 8, neni 9/1 pika 1/1 a dhe b, pika 1/3 c, nenet 10, 24, 40/4,54/k; udhëzimin plotësues nr 19 date 10.07.2025 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028”,
vendor

VENDOSI:

1. Të miratojë tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 në nivel programi sipas tabelës bashkengjitur.
2. Ngarkohet Grupi i Menaxhimit Strategjik , Drejtuesit e programeve dhe EMP për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas legjislacionit në fuqi



Drejtor
Laert Mezani

Raporti: PBA1 - Tavanet Përfundimtare të PBA

NJVQV: 160 - Bashkia Himarë

PBA: 2026 - 2028

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

	2026	2027	2028
01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi			
Shpenzime Personeli (600-601)	213,030	213,030	213,030
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	44,978	44,978	44,978
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	3,000	3,000	3,000
Tavanet e Përgjithshme	261,008	261,008	261,008
05100 - Menaxhimi i mbetjeve			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	156,501	156,501	156,501
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	156,501	156,501	156,501
03140 - Shërbimet e Policisë Vendore			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	1,500	1,500	1,500
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	10,000	10,000	10,000
Tavanet e Përgjithshme	11,500	11,500	11,500
03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile			
Shpenzime Personeli (600-601)	31,198	31,198	31,198
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	6,500	6,500	65,000
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	37,698	37,698	96,198
	2026	2027	2028
04130 - Mbështetje për zhvillimin ekonomik			

Raporti: PBA1 - Tavanet Përfundimtare të PBA

NJVQV: 160 - Bashkia Himarë

PBA: 2026 - 2028

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	25,180	25,180	25,180
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	38,300	38,300	38,300
Tavanet e Përgjithshme	63,480	63,480	63,480

04220 - Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorëve

Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	0	0	0
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	0	0	0

04240 - Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit

Shpenzime Personeli (600-601)	2,088	2,088	2,088
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	30,000	30,000	30,000
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	22,000	22,000	22,000
Tavanet e Përgjithshme	54,088	54,088	54,088

04260 - Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave

Shpenzime Personeli (600-601)	9,296	9,296	9,296
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	1,200	1,200	1,200
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	10,000	10,000	10,000
Tavanet e Përgjithshme	20,496	20,496	20,496

	2026	2027	2028
04520 - Rrjeti Rrugor Rural			
Shpenzime Personeli (600-601)	2,532	2,532	2,532
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	26,500	26,500	26,500

Raporti: PBA1 - Tavanet Përfundimtare të PBA

NJVQV: 160 - Bashkia Himarë

PBA: 2026 - 2028

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	464,509	470,557	417,956
Tavanet e Përgjithshme	493,541	499,589	446,989
04570 - Transporti Publik			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	0	0	0
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	0	0	0
06140 - Strehimi lokal dhe urbanistika			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	10,000	10,000	10,000
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	10,000	10,000	10,000
06260 - Shërbimet Publike Vendore			
Shpenzime Personeli (600-601)	69,627	69,627	69,627
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	72,200	72,200	72,200
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	141,827	141,827	141,827

	2026	2027	2028
06370 - Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	0	0	0
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	0	0	0

Raporti: PBA1 - Tavanet Përfundimtare të PBA

NJVQV: 160 - Bashkia Himarë

PBA: 2026 - 2028

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

07220 - Shërbimet e kujdesit Paresor			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	5,000	5,000	5,000
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	5,000	5,000	5,000
08130 - Sport dhe argëtim			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	5,000	5,000	5,000
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	2,000	2,000	2,000
Tavanet e Përgjithshme	7,000	7,000	7,000
08220 - Trashëgimia kulturore, monumentet, muzetë dhe bibliotekat			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	26,700	26,700	26,700
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	26,700	26,700	26,700

	2026	2027	2028
09120 - Arsimi bazë përfshirë sistemin e arsimit parashkollorollorin)			
Shpenzime Personeli (600-601)	13,590	13,590	13,590
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	9,000	9,000	9,000
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	22,590	22,590	22,590
09230 - Arsimi i mesëm i përgjithshëm			
Shpenzime Personeli (600-601)	657	657	657

Raporti: PBA1 - Tavanet Përfundimtare të PBA

NJVQV: 160 - Bashkia Himarë

PBA: 2026 - 2028

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	0	0	0
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	657	657	657
10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	3,500	3,500	3,500
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	3,500	3,500	3,500
10661 - Strehimi social			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	10,000	10,000	10,000
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	10,000	10,000	10,000

	2026	2027	2028
04940 - Fondi Kontigjence			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	0	0	0
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	0	0	0
04910 - Fondi Rezerve			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	5,000	5,000	5,000
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0

Raporti: PBA1 - Tavanet Përfundimtare të PBA

NJVQV: 160 - Bashkia Himarë

PBA: 2026 - 2028

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

Tavanet e Përgjithshme	5,000	5,000	5,000
Totali i Shpenzime Personeli (600-601)	342,019	342,019	342,019
Totali i Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	438,759	438,759	497,259
Totali i Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	549,809	555,857	503,256
Tavanet e Përgjithshme	1,330,586	1,336,634	1,342,534



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E FINANCËS DHE PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT

Nr. 5846/2 Prot

Himarë, më 21.07.2025

Lënda: Relacion shpjegues mbi miratimin e taveve përfundimtare të shpenzimeve buxhetore të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028.

KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË

KËTU

1. Baza ligjore

Ky relacion hartohet në zbatim të:

- Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”;
- Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar;
- Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”;
- Udhëzimit plotësues nr. 19, datë 10.07.2025 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028” të Ministrisë së Financave;
- Kuadrit Makroekonomik dhe Fiskal 2026-2028, miratuar me VKM nr. 83, datë 05.02.2025.

2. Qëllimi i relacionit

Ky relacion hartohet në funksion të përmbushjes së kërkesave ligjore dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026-2028.

Qëllimi kryesor i tij është të paraqesë për miratim nga Këshilli Bashkiak **tavanet përfundimtare të shpenzimeve në nivel programi**, të cilat do të shërbejnë si dokument orientues dhe kufizues për fazat e mëtejshme të planifikimit dhe përgatitjes së buxhetit të vitit 2026, si edhe për dokumentin e PBA-së që mbulon periudhën trevjeçare.

Tavanet e propozuara janë ndërtuar duke pasur në vëmendje:

- **Analizën e të ardhurave vendore** (taksat, tarifrat dhe të ardhurat e tjera të vetë bashkisë);

- **Vlerësimet e transferimeve nga buxheti i shtetit** (transferte e pakushtëzuara dhe sektoriale), sipas projeksioneve të miratuara në Kuadrin Makrofiskal 2026-2028;
- **Nevojat reale për financim** të çdo programi buxhetor, me synim garantimin e ofrimit të shërbimeve publike dhe realizimin e investimeve prioritare në territorin e Bashkisë Himarë;
- **Ruan balancën financiare të bashkisë**, duke mos tejkaluar kapacitetet aktuale fiskale.

Tavanet përfundimtare për secilin program janë hartuar në funksion të:

- Zhvillimit të qëndrueshëm të territorit;
- Ofrimit efikas të shërbimeve ndaj qytetarëve;
- Realizimit të objektivave strategjike të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Në përmbajtje, ky relacion paraqet:

- Strukturuar sipas programeve buxhetore, kufijtë maksimalë të shpenzimeve të lejuara për secilin program për vitet 2026, 2027 dhe 2028;
- Ndarjen e shpenzimeve sipas natyrës: **shpenzime personeli, shpenzime korrente të tjera dhe shpenzime kapitale.**

Tavanet përfundimtare të propozuara përbëjnë **dokument zyrtar të menaxhimit të financave publike në Bashkinë Himarë**, duke siguruar planifikim më të saktë dhe disiplinë fiskale në proceset buxhetore të viteve në vijim.

3. Përmbajtja

Përgatitja e taveve përfundimtare është realizuar në bashkëpunim me të gjithë drejtuesit e programeve buxhetore dhe Grupin e Menaxhimit Strategjik, duke marrë në konsideratë:

- Shpenzimet e domosdoshme për vijimin e funksioneve ekzistuese;
- Planifikimet për investime prioritare të nevojshme për zhvillimin lokal;
- Mundësitë reale financiare të Bashkisë, në funksion të garantimit të stabilitetit buxhetor.

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve për çdo program buxhetor janë strukturuar në tre kategori:

- **Shpenzime personeli;**

- Shpenzime korrente të tjera;
- Shpenzime kapitale.

Për periudhën 2026-2028, totali i tavaneve të përgjithshme të shpenzimeve planifikohet si më poshtë:

Viti Totali i Shpenzimeve

2026 1,330,586 mijë lekë

2027 1,336,634 mijë lekë

2028 1,342,534 mijë lekë

4. Përmbledhje sipas natyrës së shpenzimeve

Kategoria	2026	2027	2028
Shpenzime Personeli	342,019	342,019	342,019
Shpenzime Korrente të Tjera	438,759	438,759	497,259
Shpenzime Kapitale	549,809	555,857	503,256

Në zbatim të kuadrit ligjor dhe metodologjisë së miratuar nga Ministria e Financave, Bashkia Himarë ka hartuar tavane përfundimtare të shpenzimeve në nivel programi për periudhën 2026-2028. Tavanet janë ndërtuar mbi parimet e stabilitetit buxhetor, ruajtjes së funksioneve publike dhe realizimit të investimeve prioritare.

Më poshtë paraqiten analizat për secilin program:

01110 – Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi

Ky program mbulon funksionimin administrativ të bashkisë.

- **Shpenzime Personeli:** Sigurojnë vijimësinë e strukturës administrative.
- **Shpenzime Korrente:** Përfshijnë furnizime zyre, shërbime operative, mirëmbajtje sistemesh.
- **Shpenzime Kapitale:** Parashikohen investime minimale për pajisje ose përmirësime logjistike.
Analizë: Tavani është mbajtur në nivele konstante, për të garantuar efikasitet administrativ pa zgjerim të shpenzimeve operative.

05100 – Menaxhimi i Mbetjeve

Program esencial për mjedisin dhe shërbimet e pastrimit.

- **Shpenzime Korrente:** Të gjitha fondet janë të fokusuara në shërbime operative (pastrim, mbetje, transport mbetjesh).
Analizë: Financimi synon të ruajë standardet e pastërtisë në territorin e bashkisë, pa parashikuar investime kapitale.

03140 – Shërbimet e Policisë Vendore

Program për rendin dhe qetësinë publike.

- **Shpenzime Korrente:** Mirëmbajtje e mjeteve dhe pajisjeve të policisë bashkiake.
- **Shpenzime Kapitale:** Investime në pajisje, automjete ose infrastrukture të nevojshme për shërbimet e kontrollit territorial.
Analizë: Fondet kapitale synojnë modernizimin dhe eficiencën e policisë vendore.

03280 – Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile

- **Shpenzime Personeli:** Pagat për zjarrfikësit.
- **Shpenzime Korrente:** Pajisje mbrojtjeje dhe mirëmbajtje.
- **Analizë:** Për 2028 parashikohet rritje e ndjeshme e shpenzimeve korrente për menaxhimin e emergjencave civile, pas analizës së rreziqeve në territor.

04130 – Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik

- **Shpenzime Korrente:** Projekte promovimi dhe marketing lokal.
- **Shpenzime Kapitale:** Investime për përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe tregtare.
Analizë: Financimet synojnë të nxisin zhvillimin ekonomik lokal përmes ndërhyrjeve infrastrukturore dhe promovimit të turizmit.

04240 – Menaxhimi i Ujitjes dhe Kullimit

- **Shpenzime Personeli dhe Korrente:** Përdoren për mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues të kanaleve.
- **Shpenzime Kapitale:** Investime për rehabilitim dhe rikonstrukcion kanalesh.
Analizë: Financimi reflekton rëndësinë e sektorit bujqësor në njësitë rurale të bashkisë.

04260 – Menaxhimi i Pyjeve dhe Kullotave

- **Shpenzime Personeli:** Siguron administrimin dhe kontrollin teknik të këtyre pasurive.
- **Shpenzime Kapitale:** Investime në mirëmbajtje dhe përmirësime të kullotave dhe sipërfaqeve pyjore.
Analizë: Qëndron në funksion të zhvillimit rural dhe mbrojtjes së mjedisit.

04520 – Rrjeti Rrugor Rural

- **Shpenzime Kapitale:** Programi më i rëndësishëm investitor i bashkisë, që synon ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve rurale.
Analizë: Financimet shkojnë kryesisht në projekte infrastrukturore, në funksion të lidhjes së zonave rurale me qendrën administrative.

06140 – Strehimi Lokal dhe Urbanistika

- **Shpenzime Korrente:** Projekte planifikimi dhe mbështetje për ndërhyrje urbane.
Analizë: Financim, në linjë me funksionin planifikues dhe hartimin e planeve vendore.

06260 – Shërbimet Publike Vendore

- **Shpenzime Personeli dhe Korrente:** Sigurohet financimi për ndriçimin publik, mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe objekteve publike.
Analizë: Financimi ruhet konstant për të garantuar ofrimin e pandërprerë të shërbimeve publike bazë.

07220 – Shërbimet e Kujdesit Parësor

- **Shpenzime Korrente:** Mbështetje për funksionimin e shërbimeve shëndetësore bazë në territor.
Analizë: Financimi ka karakter ndihmës, për mirëmbajtjen dhe shërbime të karakterit emergjent.

08130 – Sport dhe Argëtim

- **Shpenzime Korrente dhe Kapitale:** Financim për aktivitete sportive, rehabilitim terrenesh sportive dhe blerje pajisjesh.
Analizë: Politika financiare mbështet promovimin e aktiviteteve komunitare dhe sportit në territor.

08220 – Trashëgimia Kulturore, Monumentet, Muzetë dhe Bibliotekat

- **Shpenzime Korrente:** Projekte për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.
Analizë: Financimi i këtij programi ndihmon në ruajtjen e identitetit kulturor dhe zhvillimin e turizmit kulturor.

09120 – Arsimi Bazë dhe Parashkollor

- **Shpenzime Personeli:** Financim për pagat e edukatoreve dhe mësuesve të ciklit bazë.
- **Shpenzime Korrente:** Mirëmbajtja dhe funksionimi i institucioneve arsimore.
Analizë: Financimi garanton ofrimin e shërbimeve arsimore në territor, pa investime të reja kapitale.

09230 – Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm

- **Shpenzime Personeli:** Sigurohen paga për mësuesit e arsimit të mesëm.
Analizë: Financim minimal në përputhje me strukturën aktuale arsimore në këtë cikël.

10430 – Kujdesi Social për Familjet dhe Fëmijët

- **Shpenzime Korrente:** Mbështetje financiare për kategoritë në nevojë.
Analizë: Financim, në përputhje me nevojat sociale të evidentuara.

10661 – Strehimi Social

- **Shpenzime Korrente:** Projekte për ndihmë sociale dhe asistencë për rastet në nevojë për strehim.
Analizë: Financim i dedikuar për mbështetje sociale në raste të veçanta.

04910 – Fondi Rezerve

- **Shpenzime Korrente:** Siguron një fond të vogël për përballimin e situatave të paparashikuara.
Analizë: Mbajtur në nivel minimal për menaxhimin e risqeve të mundshme financiare gjatë vitit buxhetor.

Përmbledhje përfundimtare

Totali i Tavaneve	2026	2027	2028
Shpenzime Totale (000 lekë)	1,330,586	1,336,634	1,342,534

5. Konkluzione

Bazuar në analizën e situatës aktuale financiare, pritshmëritë për të ardhurat vendore, nivelin e transferimeve nga buxheti i shtetit dhe nevojat prioritare të komunitetit, Kryetari i Bashkisë propozon miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028.

Drejtör
Laert Mezani



KRYETARI I BASHKISË
Vangjel Taxo

